



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Terreal Holding S.A.S nga shoqëria Wienerberger Participations S.A.S.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 4 Prot., i AK, datë 04.01.2023 “Blerja e aksioneve të Terreal Holding S.A.S (shoqëri aksionare tregtare) nga Wienerberger AG.”, nëpërmjet të cilës është njoftuar transaksioni për blerjen e propozuar të aksioneve të shoqërisë Terreal Holding S.A.S nga shoqëria Wienerberger AG, nëpërmjet një filiali në pronësi të plotë të tij, përkatësisht Wienerberger Participations S.A.S.

Referuar dokumentit: Letër-Përgjigje e hartuar më datë 20 dhjetor 2022, nga shoqëria Wienerberger AG, me subjekt: “Marrëveshje e së Drejtës së Shitjes për blerjen e grupit Terreal”, palët janë:

Blerësi : Wienerberger Participations S.A.S., është një shoqëri aksionare tregtare, e regjistruar sipas dispozitave të Kodit Tregtar Francez, me objekt aktiviteti: Investim i kapitalit në të gjitha shoqëritë industriale, tregtare dhe të gjitha shoqëritë e tjera, në përgjithësi të gjitha operacionet e çdo natyre, etj.

Shitësit: Persona Juridikë.

Target: Terreal Holding S.A.S., është një shoqëri aksionare tregtare, e regjistruar sipas legjislacionit Francez, me objekt aktiviteti: Kryerjen e të gjitha operacioneve, për llogari të tij, të blerjes, shitjes dhe menaxhimit të titujve të transferueshëm francez dhe të huaj të çdo natyre dhe të gjitha shoqërive, blerjen, abonimin, menaxhimin, shitjen, shkëmbimin e këtyre titujve, të gjitha shërbimet administrative, financiare, të kontabilitetit, tregtare, IT, menaxheriale ose të tjera në dobi të filialeve të shoqërisë ose të çdo shoqërie në të cilën ajo ka aksione, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.